



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 12 mars 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaqu, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje morën pjesë: OSBE, INPO, BIRN, RTK dhe Ekonomia online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën;**
- 4. Shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draft-ligjit për transmetuesin publik të Kosovës;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim - Pika e katërt, shqyrtimi i propozimeve për hartimin e draft-ligjit për transmetuesin publik të Kosovës është hequr nga rendi i ditës për t'u shqyrtuar në mbledhjen e radhës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-012 për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën

Nait Hasani njoftoi komisionin se mbledhja është e caktuar për këtë datë në dakordim me grupet e interesit që deri më 9 mars 2018, kanë mund t'i sjellin komentet e tyre lidhur me P/ligjin për Prishtinën, por meqë nuk ka propozime apo komente në adresë të komisionit, përveç atyre që komisioni ka pranuar pas miratimit në parim të P/ligjit. Komisioni është në procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve të adresuara nga grupet e interesit dhe hartimit të propozim amendamenteve nga komisioni.

Konstatim: Komisioni shqyrtoi veç e veç të gjitha propozimet e komentet e adresuara në komision nga grupet e interesit dhe shqyrtoi P/ligjin nen për nen dhe pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, komisioni miratoi këto propozim amendamente si vijon:

Amendamenti 1

Neni 3, paragrafi 1.1.3, fshihet fjala “**Kryetari**”, zëvendësohet me fjalën “**Kryesuesi**”.

Amendamenti 2

Neni 7, titulli i këtij neni ndryshohet si vijon: “**Kompetencat për Kryeqytetin**”.

Amendamenti 3

Neni 7, paragrafi 1.1.1. Mbetet për sqarim.?????????

Amendamenti 4

Neni 7, paragrafi 1.2.1. riformulohet si vijon: “**Kryeqyteti ka kompetenca për afrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor**”.

Amendamenti 5

Neni 7, paragrafi 1.2.2. pas fjalës “**spitalin e**” shtohet fjalët “**përgjithshëm dhe të**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 6

Neni 11, paragrafi 6. fshihet në tërësi, ndërsa paragrafi 7 bëhet 6.

Amendamenti 7

Neni 15, paragrafi 3. fshihet fjala “**tre**”, zëvendësohet me fjalën “**pesë**”.

Amendamenti 8

Neni 17, paragrafi 5, fshihen fjalët: ”të kryeqytetit”.

Amendamenti 9

Neni 19, paragrafi 5. fshihet fjala “sekondare”, zëvendësohet me fjalën “dytësore”.

Amendamenti 10

Neni 19, paragrafi 7, fshihet fjala “LFPL”, zëvendësohet me fjalët “Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal”.

Amendamenti 11

Neni 19, shtohet paragrafi i ri **8,** si vijon: **“Kryeqyteti cakton taksë shtesë për kryeqytetin”.**

Komisioni shqyrtoi amendamentin e deputetit, z. Lumir Abdixhiku, për nenin 19, paragrafi 1 dhe e përkrahu unanimisht.

Mbledhja përfundoi në orën:12:45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani